

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/falsifikime-dhe-shperdorim-detyre-pezullohen-dy-zyrtare-ne-t-irane-shp-i514651
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:18:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:08:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6e5eaaa89e7286472d84024d08b2efe47cab77008aeeb9c00828a29e88b2b510
TEKSTI	54bbb6df4d3988ecd80219862808e9b918589661c126ff2950abd1eb1fab08c6
PAMJA	e51138b964efbd374cbfc1a8ced47393b40ce0a8ae3a779d23ae86837082fa2e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	56b4ebba0e1e005236b766c4362e41070cbec659d7c4026e2ca81925d9e5401d
E MËPARSHMJA	bdc7ca211321532802fbd85cf5a2876d7a143258f388944050dcfa30bcf2f265
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/56b4ebba0e1e005236b766c4362e41070cbec659d7c4026e2ca81925d9e5401d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

1 ORE ME PARË

Vendimi i Hagës nxit protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

5 ORE ME PARË

Prëzohet kërkesa e PD që të mos votohet drafti për pagat e magistratëve, Balla: Hipokrizi! Bardhi: Tërhiqeni ligjin

5 ORE ME PARË

"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, përplasen me policinë, shoqërohen disa prej tyre

20 ORE ME PARË

Dita e 109-të e protestës kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh: Nesër protestë para Parlamentit

Aktualitet

Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete

Bëhet me dije se 41-vjeçari i dënuar më parë për veprën penale të mashtrimit, dyshohet se ka aplikuar për ndryshimin e emrit të tij, me dokument identifikimi të falsifikuar. Ndërsa dy zyrtarët e tjerë dyshohet se kanë kryer procedurat në vijim të këtij aplikimi, pa kryer verifikimet përkatëse mbi dokumentacionin e paraqitur.



17 Shtator 2026, 15:08
Nga E. D



foto ilustruese

TIRANË- Dy zyrtarë janë pezulluar nga detyra dhe një shqiptaro-izraelitit është shpallur në kërkim. Sipas njoftimit të Prokurorisë, punonjësja e një njësie administrative në Tiranë dhe specialisti IT në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile janë pezulluar nga detyra. Ndërkohë në kërkim është shpallur shqiptaro-izraeliti me tre identitetet (David Isaac alias Indrit Kolleshi alias Indrit Aliu).

Bëhet me dije se 41-vjeçari i dënuar më parë për veprën penale të mashtrimit, dyshohet se ka aplikuar për ndryshimin e emrit të tij, me dokument identifikimi të falsifikuar. Ndërsa dy zyrtarët e tjerë dyshohet se kanë kryer procedurat në vijim të këtij aplikimi, pa kryer verifikimet përkatëse mbi dokumentacionin e paraqitur.

Sipas hetimeve Indrit Aliu rezultojnë se ka ndryshuar emrin dhe mbiemrin në David Isaac, në Zyrën e gjendjes civile në Njësinë Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë, dhe më datë 27.11.2025 nga ana njësisë administrative nr.5 Tiranë, ku ky person rezultojnë banor, u konstatua ndryshimi gjatë kontrollit të procedurës për riaplikim për pasaportë biometrike dhe ju vendosën gjeneralitetet e mëparshme nga David Isaac në Indrit Kolleshi.

Më pas më datë 29.12.2025 me një kërkesë për ndryshimin e vendbanimit nga njësia Administrative nr.3 Bashkia Tiranë u kryen veprime për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit sipas një certifikate që mban të dhënat e Ministrisë së Brendshme të Izraelit nga Indrit Kolleshi në David Isaac të dhëna që mbahen dhe aktualisht nga 41-vjeçari.

Njoftimi i Prokurorisë

Prokuroria rranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përmithshëm Tiranë kërkoi caktimin e masës së

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:46

"Urime për look-un e ri"/ Muçi
ironizon deputeten socialiste,
Zegjine Çausi i përgjigjet
ashpër: O psikopat, na hape
barkun

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:22

Me cigare në dorë/ Monika
Kryemadhi bashkëbisedon
me protestuesit para SPAK:
Bashkohuni dhe organizohuni
mes jush!

sigurimit 'Arrest në burg' në mungesë për shtetasin nën hetim D.I. alias I.K. alias I.A., i dyshuar për veprën penale të 'Falsifikimi i dokumenteve' parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal si dhe masat e sigurimit 'Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik' për shtetasit O.O. punonjëse në njësinë administrative nr.3 në Tiranë dhe shtetasin A.K., IT në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë së Brendshme.

Nga hetimet mbi procedimin penal nr. 5052 të vitit 2026, rezultoi se shtetasi I.A. i dënua më parë për veprën penale të mashtrimit, me veprimet e tij aktive ka cenuar veprimtarinë normale të organeve shtetërore si dhe marrëdhëniet e shtetit shqiptar ndërkombëtarisht duke përdorur dokumente të falsifikuara sikur janë lëshuar nga shteti i Izraelit. Personi nën hetim, tregon me veprimet e tij për një rrezikshmëri të lartë shoqërore, duke përdorur dokumente të falsifikuara për t'u pajisur më tej me dokumente identiteti të rreme si kartë identiteti dhe pasaportë biometrike për të lëvizur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shtetasi I.A. alias I. K., rezultoi se ka ndryshuar emrin dhe mbiemrin në D.I., në Zyrën e gjendjes civile në Njësinë Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë, dhe më datë 27.11.2025 nga ana njësisë administrative nr.5 Tiranë, ku ky person rezultoi banor, u konstatua ndryshimi gjatë kontrollit të procedurës për riaplikim për pasaportë biometrike dhe ju vendosën gjeneralitetet e mëparshme nga D. I. në I. K.

Më pas më datë 29.12.2025 me një kërkesë për ndryshimin e vendbanimit nga njësia Administrative nr.3 Bashkia Tiranë u kryen veprime për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit sipas një certifikate që mban të dhënat e Ministrisë së Brendshme të Izraelit nga I.K. në D.I., të dhëna që mbahen dhe aktualisht nga ky shtetas.

Organi procedues çmon se ka dyshime se ndryshimet e emrit dhe mbiemrit janë kryer në kundërshtim me ligjin 10129 datë 11.05.2009 "Për gjendjen Civile" dhe se dokumentet në gjuhën hebraike të paraqitura nga ky shtetas të jetë të falsifikuara.

Punonjësja e Gjendjes civile të Zyrës së Gjendjes Civile të Njësisë Bashkiake nr.3 Tiranë O.O. duket se ka pranuar në kundërshtim me ligjin një akt të emërtuar certifikatë për ndryshimin e emrit të lëshuar sipas dokumentit nga Ministria e Brendshme e Shtetit të Izraelit. Kjo shtetase ka pasur të dhënat në sistemin e gjendjes civile dhe nuk duhet të pranonte këtë dokument si të vlefshëm për të vijuar me ndryshimin e emrit dhe mbiemrit.

Organi procedues çmon se, dokumenti i emërtuar si certifikatë e Ministrisë së Brendshme Izraelite, nuk mund dhe nuk duhet të ishte i vlefshëm, i pashoqëruar me akte të tjera si kërkesa për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit dhe punonjësja e gjendjes civile ka patur detyrimin për verifikimin dhe analizën dhe të mospranonte regjistrimin e këtij ndryshimi.

Ndërkohë që nga hetimet rezultoi se ndryshimi i të dhënave është bërë nga një user, mbajtësi i të cilit kishte dalë prej vitesh në pension dhe se nga ky user, janë kryer një numër shumë i lartë veprimesh për ndryshime në gjendjen civile për persona që kanë probleme me ligjin, të dënua, të deportuar nga vendet e Bashkimit Evropian etj. Për këtë arsye, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë kërkoi masën e sigurimit "Pezullimi i ushtrimit të një detyre" për personat nën hetim O.O. dhe A.K./Dosja.al

policia e tiranes

Sondazh

Poll

AKTUALITET 17 SHTATOR 2026, 10:41

"Ramoviç jep dorëheqjen sa më parë!" / Vijon protesta pranë Kuvendit, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama (VIDEO)

më të klikuarat

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare le vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro



Të shtënat me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një avokat, policia në kërkim të autorit (EMRAT+PAMJET)

Arrestohet kushëriri i Ergys Agasi/ Eno Agasi zhduku verën miliona euro nga kantina djalit të xhaxhait

"Dënimi i Thaçit është skandaloz"/ Richard Grenell kërkon mbylljen e Gjykatës Speciale: Kurti të veprojë menjëherë

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.

Aktualitet
17 Shtator 2026, 13:45

Haga dënoi me 81 vite burg në total ish-krerët e UÇK-së/ Studentët në Prishtinë nisin protestat, kërkojnë drejtësi: MARRE

Pamje PRISHTINA- Dhjetëra studentë janë grumbulluar në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë ditën e sotme,...

Grabitën me dhunë dy pika karburanti në Bulqizë, identifikohet njëri prej autorëve dhe shpallet në kërkim një tjetër

Aktualitet
17 Shtator 2026, 13:35

Pjesë e objektit të EULEX-it përfshihet nga zjarri në protestën kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

Aktualitet
17 Shtator 2026, 13:30

Haga dënoi Kosovën/ Mark Ellis: Aktgjykimi mund të sfidohet si në fakte, ashtu edhe në ligj

Aktualitet
17 Shtator 2026, 13:19

RTSH hap një kapitull të ri: Identitet i ri vizual, programe të reja dhe pesë superprodhime në sezonin e ri

Aktualitet
17 Shtator 2026, 13:11

Aktualitet
17 Shtator 2026, 13:01

Protestat te Zogu i Zi/ Civkata e Tiranës liron

Protestuesit e Zogut 127 Gjykata e Tiranës merr protestuesit e shoqëruar në komisariat: Arrestimi i tyre ishte i paligjshëm

Pamje TIRANA- Gjykata e Tiranës ka liruar protestuesit e shoqëruar në komisariat, duke argumentuar se arrestimi i tyre ishte i paligjshëm...

KMD shkon te qytetarët/ Nis turi në 10 bashki për të drejtat dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Aktualitet

17 Shtator 2026, 13:00

Përshkallëzohet situata jashtë Kuvendit/ Protestuesit godasin me vezë, shoqërohet Dritan Goxhaj dhe disa të tjerë

Aktualitet

17 Shtator 2026, 12:51

VIDEO/ Viojnë tensionet në protestë, qytetarët përmbysin kazanët e mbeturinave para selisë së PD

Aktualitet


17 Shtator 2026, 12:29

Sërish tensione jashtë Kuvendit/ Policia thirrje qytetarëve: Lironi rrugën ose do veprojmë ne

Aktualitet

17 Shtator 2026, 12:19

MË SHUMË



Përplasje mes efektivëve të policisë dhe protestuesve,



Përplasje mes efektivëve të policisë dhe protestuesve, policia shoqëron dy të mitur

Berisha në Kuvend: Jeni bërë ushtarë të Padronit dhe Yeffet-it, po i jepni paratë kompanisë së Ramës

Balla: Të shtyjmë deklaratën e përbashkët për "Hagën" se mungon Agroni?!

Zhupa: Rama shkoi me avion special në Kosovë dhe kërkoi votën për Gjykatën Speciale

Shiko video te tjera



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.